

**FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVA**



STATUTI

Gusht 2017

Në bazë të nenit 9 të Ligjit mbi lirinë e asociimit në OJQ dhe nenit 27 e 31, kapitulli VI i Ligjit për Sport të Kosovës, nr 2003/24, udhëzimit administrativ nr. 02/2005 dhe vullnetit të lirë të delegatëve të Kuvendit të FFK-së, Kuvendi i Federatës së Futbollit të Kosovës, në seancën e vet të mbajtur më 25 Gusht 2017, miratoi këtë:

STATUT

Të Federatës së Futbollit të Kosovës

Shënimet paraprake :

- **Kuvendi** (Kongresi, Asamblea), do të thotë, Kuvend i përgjithshëm, mbledhja e delegatëve në Kuvend.
- **Komiteti Ekzekutiv** (KE) do të thotë Komiteti i zgjedhur nga Kuvendi si organi më i lartë ekzekutiv i Federatës së Futbollit të Kosovës.

I DEFINICIONET

Konventat e mëposhtme gjuhësore janë përdorur për të interpretuar, si vijon:

- **FFK:** Federata e Futbollit e Kosovës;
- **FIFA:** Federata Ndërkombëtare Botërore e Asociacioneve të Futbollit;
- **UEFA:** Unioni i Bashkuar i Futbollit European;
- **CAS:** Gjykata Sportive e Arbitrazhit në Lozanë (Zvicër);
- **IFAB:** Bordi Ndërkombëtar i Shoqatave të futbollit;
- **GJAS e KOK:** Gjykata e Arbitrazhit sportiv e Komitetit Olimpik të Kosovës;
- **LRF:** Lidhjet Rajonale të Futbollit të Federatës së Futbollit të Kosovës;
- **Klubi :** anëtarë i FFK-së;
- **Zyrtarët:** të gjithë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv, trajnerët, gjyqtarët dhe personat e tjerë përgjegjës për çështje teknike, mjekësore dhe administrative në FIFA, UEFA, FFK dhe klube;
- **Lojtari:** lojtari i regjistruar në FFK;
- **Anëtarët:** të gjithë personat fizik ose juridik që janë të pranuar nga FFK-ja.

II DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Forma ligjore, emri dhe selia

1. Federata e Futbollit e Kosovës, është organizatë joqeveritare, jo profitabile, e pavarur dhe vullnetare sportive e cila mund të bashkohet në bazë të Ligjit për OJQ dhe Ligjit për Sport të Kosovës. Është e themeluar në kohë të pacaktuar .
2. FFK-ja është neutrale në çështjet e politikës, fesë dhe ndalon çdo formë të diskriminimit politik, fetar, gjinor, etnik ose racial. Ajo respekton autoritetin e shtetit.
3. Selia e FFK-së është në Prishtinë, rruga 28 Nëntori, nr. 171, Prishtinë.
4. Shkurtesa e Federatës së Futbollit të Kosovës është FFK.

FFK-ja është anëtare e plotë e UEFA-s (3 Maj 2016) dhe e FIFA-s (13 Maj 2016).

FFK-ja dhe anëtarët e saj do t'i respektojnë të gjitha Statutet, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-së dhe UEFA-së.

Neni 2 Flamuri, emblema llogoja dhe gjuha

1. Flamuri i FFK-së ka ngjyrë të kaltërt dhe në mes përmban amblemën e FFK-së.
2. Emblema e FFK-së përmban ngjyrën e kaltërt, mbishkrimin në tri gjuhë: Shqip, Serbisht dhe Anglisht. Ka në mes gjashtë yje dhe topin me ngjyrë të artë dhe të bardhë.
3. Vula është rrethore me stemën e FFK-së.
4. Gjuha zyrtare është Gjuha Shqipe dhe Serbe. Në rast divergjence mes interpretimeve të teksteve në gjuhë të ndryshme gjuha shqipe është autoritative.

Neni 3 Statusi Juridik

1. FFK-ja është organizata e vetme kompetente që organizon, udhëheqë dhe rregullon garat e futbollit në teritorin e Republikës së Kosovës.
2. Ajo është organizatë jopolitike, joprofitabile e themeluar në principet e frymës sportive dhe fair play-it.

3. Të drejtat, detyrat dhe obligimet janë të definuara me këtë Statut, Ligjin për Sport dhe aktet normative të FFK-së.
4. FFK-ja është e regjistruar në Regjistrin e organizatave sportive, konform legjislaturës së Republikës së Kosovës.

Neni 4 Anëtarësia në organizatat sportive

1. FFK-ja është një ndër themeluesit dhe anëtare me të drejta të plota, e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK).
2. FFK-ja është anëtare me të drejta të plota në organizatat ndërkombëtare të futbollit FIFA e UEFA.
3. FFK-ja obligohet që:
 - a) do të respektojë Statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-së dhe UEFA-së, si dhe kodin moral të FIFA-së;
 - b) do të respektojë rregullat e lojës të përcaktuara nga IFAB;
 - c) do të pranojë kompetencën e "CAS" dhe do t'i respektojë vendimet e saja;
 - d) të gjitha kontestet në garat nacionale lidhur me shkeljen e akteve normative (përveç kontesteve për të cilat janë kompetente organet e UEFA-s dhe FIFA-s) do t'i përcjell në instancën e fundit-në gjykatën e arbitrazhit sportiv, në instancat tjera të rregullta juridike sportive dhe do të respektojë kalendarin ndërkombëtar të futbollit;
 - e) do të kujdeset për të drejtat dhe obligimet tjera që dalin nga Statuti, rregulloret dhe vendimet e FIFA-së dhe UEFA-së;
 - f) siguron që anëtarët e FFK-së, ligat, klubet, lojtarët dhe personat zyrtar do të respektojnë obligimet e lartpërmendura nëpërmjet statuteve të tyre.

Neni 5 Qëllimet

Qëllimet (objektivat) e FFK-së janë këto :

- a) të zhvillojë, promovojë, kontrollojë dhe rregullojë në mënyrë konstante lojën e futbollit në të gjitha format e tij në teritorin e Republikës së Kosovës, në dritën e fair play-it, vlerave kulturore, edukative dhe humanitare, sidomos nëpërmjet masovizimit dhe zhvillimit të programeve për të rinj;
- b) të organizojë garat e FFK-së në nivel nacional në të gjitha kategoritë (senior, pionier, kadet, juniorë, futboll të vogël-futsal, futboll të femrave, etj);
- c) të organizojë dhe drejtojë garat e futbollit duke i zhvilluar dhe afirmuar;
- d) të respektojë dhe mbrojë Statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FIFA-së, UEFA-së, si dhe rregullat e lojës, duke u kujdesur që ato të respektohen nga anëtarët e saj;
- e) të mbikqyrë dhe kontrollojë të gjitha ndeshjet zyrtare dhe miqësore në të gjitha format e saja, që luhen në teritorin e Kosovës;
- f) të drejtojë marrëdhënjet ndërkombëtare sportive dhe ato nacionale të lidhura me Federatën e Futbollit të Kosovës në të gjitha format e saj;
- g) të parandaloj të gjitha metodat dhe aktivitetet, të cilat do të mund të rrezikonin integritetin e ndeshjeve dhe garave ose që do të keqpërdornin lojën e futbollit.

Neni 6 Detyrat

1. FFK-ja në bazë të qëllimeve të lartpërmenduar obligohet që:

- a) të organizojë, administrojë dhe sanksionojë me norma, futbollin në Kosovë.
- b) të organizojë dhe mbikqyrë garat e futbollit konform këtij Statuti;
- c) të rregullojë me akte normative të drejtat dhe detyrat e çdo anëtari të FFK-së, të sjellë vendime mbi statusin e anëtarëve, të nxjerr aktet e tjera juridike dhe t'i njoftojë anëtarët për obligimet që dalin nga ato dhe Statuti i FIFA-së dhe UEFA-së;

- d) që të afirmoj punën profesionale të personelit të futbollit siç janë, lojtarët, gjyqtarët, trajnerët, personeli mjekësor, delegatët, administratorët dhe ekspertët e tjerë të futbollit;
- e) të sanksionojë dhe rregullojë qështjet që janë të lidhura me statusin e klubeve lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve dhe personelit tjetër në futboll, si dhe regjistrimin e lojtarëve, personave zyrtar dhe organizatës së futbollit;
- f) të organizojë ndeshjet e futbollit të Përfaqësueses së Kosovës;
- g) të krijojë kushte për financimin e aktiviteteve të Përfaqësueses dhe aktiviteteve ndërkombëtare të futbollit, shkollimin e personelit, si dhe punën e organeve dhe shërbimit administrativ të FFK-së;
- h) Të përmbushë obligimet tjera në interes të FFK-së dhe anëtarëve të saj, konform legjislaturës së Kosovës dhe këtij statuti;

III ANËTARËSIA

Neni 7

1. Anëtarët e FFK-së janë:
 - a) Shtatë Lidhjet Rajonale të Futbollit (mëtutje LRF) :
 1. LRF e Prishtinës,
 2. LRF e Pejës
 3. LRF e Mitrovicës,
 4. LRF e Prizrenit,
 5. LRF e Gjakovës,
 6. LRF e Gjilanit,
 7. LRF e Ferizajit,
 - b) Klubet e Futbollit janë anëtare të FFK-së, të regjistruara zyrtarisht në një të një nga shtatë LRF-të, si dhe garojnë në një të një nga ligat e organizuara nga FFK-ja.
 - c) Shoqatat Profesionale të futbollit janë të pavarura por në kuadër të FFK-së, kanë selinë në Prishtinë dhe ato janë :
 - a. Shoqata e Gjuqtarëve të futbollit të Kosovës (mëtej SHGJK),

- b. Shoqata e trajnerëve të futbollit të Kosovës (mëtej **SHTK**).
2. Organizatat tjera sportive të lidhura me futbollin mund të kërkojnë pranim dhe anëtarësimin e FFK-së konform këtij Statuti.

Neni 8 Lidhjet Rajonale të Futbollit

1. Shtatë Lidhjet Rajonale të Futbollit, anëtare të FFK-së, të cekura më lartë mbulojnë teritorin e caktuar nga Komiteti Ekzekutiv i FFK-së (mëtej KE) dhe janë përgjegjes për organizimin, administrimin dhe udhëheqjen e garave të futbollit në rajonin e vet në bazë të këtij Statuti.
2. Çdo LRF duhet të ketë së paku pesë (5) klube të futbollit të regjistruara, për të pasur statusin e anëtarit të FFK-së.
3. Çdo LRF përbëhet nga klubet futbollistike, shoqatat profesionale të futbollit ose shoqatat e posaqme të futbollit të anëtarësuara në atë rajon.
4. LRF-të janë njësi të FFK-së, mund të zvogëlohen, bashkohen apo të shtohen në bazë të vendimeve të Kuvendit të FFK-së lidhur me riorganizimin e Futbollit në R. e Kosovës.
5. Statuti i LRF-së duhet të miratohet nga ana e FFK-së dhe ai duhet të jetë konform Statutit të FIFA-së, UEFA-së dhe FFK-së.

Neni 9 Klubet futbollistike

1. Klubi futbollistik është organizata themelore juridike që organizohet dhe merr pjesë në garat e futbollit të organizuara nga FFK dhe LRF-të e saja.
2. Çdo klub futbollistik duhet të jetë i regjistruar në bazë të ligjeve në fuqi, në njërin nga shtatë LRF-të, gjegjësisht në Rajonin të cilit i përket gjeografikisht.
3. Çdo klub mund të aplikojë për pjesëmarrje në garat rajonale, nacionale dhe ndërkombëtare, në bazë të të arriturave sportive dhe plotësimit të kriterëve të përcaktuara me rregullore dhe duke i përmbushur të drejtat dhe obligimet e saja në LRF dhe FFK.

4. Mënyrat e organizimit dhe funksionimit të klubit futbollistik, janë të rregulluara me Statutin, Rregulloret, vendimet e tyre të cilat duhet të jenë konform legjislacionit shtetëror dhe të instancave të futbollit.
5. Çdo lojtar apo person zyrtar i klubit futbollistik duhet të jetë i regjistruar si individ në LRF, konform rregulloreve përkatëse për regjistrim.

Neni 10 Shoqatat profesionale të futbollit

1. Shoqata profesionale e futbollit është shoqatë individuale e cila merret posaqërisht me çështjet e gjyqtarëve, trajnerëve, të personelit mjekësor, gazetarëve sportiv etj.
2. Shoqata e tillë duhet të jetë anëtare e LRF-së me të cilën është i lidhur gjeografikisht apo është direkt i lidhur me FFK-në (shoqata e gjyqtarëve dhe e trajnerëve).
3. Shoqatat profesionale të futbollit kujdesen për edukimin dhe rekrutimin e ekspertëve të lëmisë përkatëse në harmoni me qëllimet e FFK-së.
4. Është në kompetencë të FFK-së të shkollojë dhe edukojë këta ekspertë lidhur me aktivitetet e tyre në teritorin e Kosovës.
5. Organizimi dhe funksionimi i Shoqatave profesionale të futbollit rregullohen me Statutet, rregulloret dhe vendimet vetanake, të cilat duhet të jenë në harmoni me legjislaturën e Kosovës, dhe aktet normative të LRF-së, FFK-së, UEFA-së dhe FIFA-së.
6. Çdo ekspert nga këto shoqata duhet të regjistrohet konform rregulloreve për regjistrim të FFK-së.
7. Shoqatat profesionale për punën e tyre i përgjigjen dhe raportojnë rregullisht KE-së.

Neni 11 Kërkesa për anëtarësim

1. Çdo aplikim për anëtarësim në FFK duhet të shoqërohet nga kërkesa në formë të shkruar.
2. Në kërkesë aplikuesi duhet të sjellë këto dokumente
 - a) Deklaratën me të cilën vërtetohet si vijon:
 - se aplikuesi dëshiron të bëhet anëtar i FFK-së,
 - se do t'i përmbahet aketeve normative të FFK-së, UEFA-së dhe FIFA-së dhe rregullave të lojës të përcaktuara nga IFAB;
 - se do të pranojë të gjitha instancat gjyquese sportive si dhe gjykatën sportive të arbitrazhit (CAS) në Lozanë;
 - se do të pranojë kompetencën e Gjykatës së Arbitrazhit sportiv të KOK-ut;
 - vërteton se selia e saj është në teritorin e Republikës së Kosovës;
 - garanton se ai do t'i zhvillojë të gjitha ndeshjet zyrtare në teritorin e Kosovës, pas miratimit nga FFK-ja;
 - garanton se ai mund të marrë vendime të cilat kërkohen nga anëtarësia e tij në FFK,
 - b) Kopjen e Statutit dhe rregulloreve të tyre,
 - c) Çertifikatën e regjistrimit në drejtorinë komunale për sport të komunës përkatëse,
 - d) Dokumentet që përmbajnë këto informacione:
 - emrin, selinë, organet dhe qëllimet;
 - listën e anëtarëve aktual;
 - listën e personave zyrtar, funksionet dhe adresat e tyre, duke potencuar të autorizuarit për nënshkrimin e dokumentave me të drejtë të lidhjes së kontratave me personat e tretë;
 - kopjen e procesverbalit nga Kuvendi i tyre i fundit ose nga mbledhja e tyre konstituive dhe
 - pagesën e përcaktuar me rregulloren përkatëse.

Neni 12 Kërkesa dhe procedura për aplikim

1. Kjo procedurë rregullohet me rregulloren për regjistrimin e klubeve të cilën e miraton KE i FFK-së;
2. Shërbimi administrativ i FFK-së verifikon kompletimin dhe përmbajtjen e dokumentacionit të aplikuesit të deponuar nga klubi dhe LRF përkatëse dhe ia dërgon në miratim KE-së;
3. KE-ja do të kërkon nga Kuvendi që të pranojë apo jo aplikuesin, ndërsa Kuvendi do të vendosë në mënyre meritore;
4. Midis dy Kuvendeve, KE-ja jepë anëtarësim provizor pas kërkesës dhe aplikacionit të plotë ligjor, në përputhje me këtë Statut;
5. Anëtari i ri i pranuar do të ketë të drejtat dhe detyrat e barabarta, ndërsa delegatët e tyre mënjëherë pas kësaj kanë të drejtë të votojnë dhe të zgjedhen;

Neni 13 Të drejtat e anëtarëve

1. Anëtari i FFK-së ka këto të drejta
 - a) të marrin pjesë në Kuvendin e FFK-së, të thirren në kohën e caktuar me Statut, të jenë të njohur me rendin e ditës dhe të shfrytëzojnë të drejtën e tyre të votës.
 - b) të japin propozime për rendin e ditës së Kuvendit;
 - c) të propozojë kandidatët për të gjitha organet e FFK-së;
 - d) të kërkojnë kuvendin e jashtëzakonshëm me mbështetjen e anëtarëve të tjerë delegatë;
 - e) të jenë të informuar mbi aktivitetet e FFK-së nëpërmjetë trupave zyrtarë;
 - f) të marrin pjesë në garat dhe aktivitetet tjera të organizuara nga FFK;
 - g) t'i realizoj të gjitha të drejtat që dalin nga ky Statut, rregulloret apo vendimet e FFK-së;

Neni 14 Obligimet e anëtarëve

1. anëtarët e FFK-së i kanë këto obligime:

- a) që plotësisht t'i përmbahen Statutit, rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të FFK-së, UEFA-së dhe FIFA-së dhe që të sigurojë që këtë do ta bëjnë edhe anëtarët e saj;
- b) të jenë korrekt ndaj FFK-së dhe të paguajnë të gjitha detyrimet financiare ndaj saj;
- c) t'i komunikojë FFK-së çdo ndryshim në aktet e saja normative dhe në listën e personave zyrtarë dhe të të autorizuarve për nënshkrim;
- d) t'i respektoj rregullat e lojës së IFAB, rregullat e lojës së futbollit të vogël dhe kodin etik të FIFA-së;
- e) që aktet e saja normative të parashohin që, të gjitha mosmarrëveshjet në nivel nacional do t'ia drejtojnë, si instancë e fundit, komisionit për arbitrazh të KOK-ut dhe me të cilën njohin kompetencën e Gjykatës së arbitrazhit sportiv (CAS) në Lozanë, Zvicër;
- f) të sigurojë zgjedhje të lira për organet e veta ekzekutive;
- g) të merr pjesë në Kuvendin e FFK-së, të zgjedhë apo të kandidojë delegatët e vetë për Kuvend;
- h) të merrë pjesë në garat apo aktivitetet e organizuara nga FFK-ja, qoftë në nivel nacional qoftë në atë ndërkombëtar, konform kalendarit zyrtar;
- i) janë përgjegjës të dhe në FFK dhe mund të sanksionohen në bazë të rregulloreve disiplinore në rast të mos përmbushjes së obligimeve apo thyerjes së rregullave që rrjedhin nga aktet normative të FFK-së dhe organeve të saj;
- j) të udhëheq evidencën e regjistrimit të të gjithë anëtarëve;
- k) të bashkëpunojë në mënyrë të plotë me FFK-në, me organet dhe trupat e saja me qëllim të zhvillimit të lojës së futbollit;
- l) Të respektoj integritetin dhe unitetin e FFK-së;

- m) Të respektoj principet e lojalitetit, integritetit, frymës sportive dhe fair play-it;
 - n) Të mos ketë kurrfarë lidhje të natyrës sportive me trupat të cilat nuk janë të njohura, me anëtarët e suspenduar apo të larguar;
 - o) Të mos lejojnë diskriminimin e çdo lloji kundër vendit, personave privat apo grupeve, në bazë të përkatësisë etnike, gjuhësore, religjioze, gjinore, politike apo për arsye tjera;
 - p) Për çdo kontakt me organet e UEFA-së dhe FIFA-së, të marrin pëlqimin e FFK-së, paraprakisht;
 - q) Të respektojnë të gjitha obligimet tjera që dalin nga Statuti, rregulloret dhe vendimet e FFK-së UEFA-së dhe FIFA-së.
2. Kryerja e këtyre obligimeve i nënshtrohet dispozitave të tjera në këtë Statut dhe rregulloreve në fuqi.
 3. Mospërbushja e obligimeve të lartpërmenduar nga ana e cilitdo anëtar mund të sjellë deri te sanksionet konform këtij Statuti.

Neni 15 Dorëheqja

1. Anëtar i FFK-së mund të heqë dorë nga anëtarësia, duke bërë kërkesën me shkrim 6 muaj më parë dhe në fund të vitit financiar.
2. KE-ja e përcjellë kërkesën në Kuvendin e radhës, pasi që anëtar i dorëheqje t'i përmbushë obligimet financiare ndaj FFK-së.

Neni 16 Suspendimi

1. Kuvendi ka të drejtë për suspendimin e anëtarëve të FFK-së në rastë se ata :
 - a) nuk i përmbushin obligimet e tyre financiare ndaj FFK-së apo anëtarve të tjerë;
 - b) shkelin seriozisht dispozitat e Statutit të FFK-së, rregulloreve dhe vendimeve të saj;
 - c) rrezikojnë unitetin e FFK-së, apo humbë karakteristikat e anëtarit të FFK-së.

2. KE-ja mund të suspendojë menjëherë një anëtarë të tillë në bazë të përkohshme e cila do të vlejë deri në kuvendin e radhës, nëse në ndërkohë nuk tërheqet suspendimi.
3. Suspendimi vërtetohet në kuvendin e radhës, në të kundërtën ajo tërhiqet automatikisht;
4. anëtarë i suspenduar apo përkohësisht i suspenduar humbë të drejtat e saja nga anëtarësia. Anëtarët e tjerë nuk mund të kenë kontakte sportive me anëtarin e suspenduar.
5. Organet vendimmarrëse të FFK-së mund të shqiptojnë sanksione shtesë konform rregullorës disiplinore.

Neni 17 Përrjashtimi

1. Kuvendi është përrjegjës për përrjashtimin e anëtarëve të FFK-së, cilët:
 - a) disa herë nuk i përrmbushin obligimet e tyre financiare ndaj FFK-së;
 - b) seriozisht dhe shumë herë thyejnë dispozitat e akteve normative të FFK-së, FIFA-së apo UEFA-së.

Neni 18 Humbja e Statusit të anëtarit

1. statusi i anëtarit mbaron me dorëheqjen, përrjashtimin ose shkrirjen e tij.
2. humbja e statusit të anëtarit nuk e liron atë nga përrmbushja e detyrimeve financiare ndaj FFK-së apo organeve të tjera .
3. me humbjen e statusit të anëtarit ndërpriten të gjitha të drejtat të lidhuara me FFK, UEFA dhe FIFA .
4. Aplikohet rregullorja e Kuvendit.

Neni 19 Shkrirja e anëtarit

Shkrirja e subjektit (ligjor) të një anëtarë mund të jetë vullnetare ose ligjore dhe humbë statusin e anëtarit edhe përpara arritjes së momentit të likuidimit.

Neni 20 Statusi i Lidhjeve Rajonale , Shoqatave Profesionale dhe klubeve

1. LRF-të, Shoqatat profesionale, klubet dhe çfarëdo lloji grupi i asociuar në FFK do të jenë të nënshtruara dhe të njohura nga FFK-ja.
2. Ky Statut definon rrethin e autorizimeve si dhe të drejtat dhe detyrat e trupave të tilla të futbollit dhe grupeve.
3. Në çdo rast asnjë person fizik apo juridik nuk mund të ushtrojë kontrollin në më shumë se një klub ose grup.
4. Aktet e tyre normative duhet të miratohen nga ana e KE të FFK-së dhe duhet të jenë në harmoni me legjislaturën nacionale, statutet, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FFK-së UEFA-së dhe FIFA-së.

Neni 21 Mirënjohjet dhe shpërblimet

1. FFK-ja ndanë mirënjohje dhe shpërblime individëve dhe organizatave sportive për merita të posaçme në zhvillimin e futbollit dhe për këtë formon komisionin përkatës.
2. KE-ja miraton rregulloren për mirënjohje dhe shpërblime në të cilën përcakton procedurën, kushtet dhe afatet për zgjedhjen e kandidatëve.

Neni 22 Kryetari i nderit dhe anëtarët e nderit

1. KE-ja mund ti propozojë Kuvendit, titullin për kryetar nderi dhe anëtarë nderi për merita të jashtëzakonshme në futboll.
2. Kryetari dhe anëtarët e nderit mund të marrin pjesë në punën e Kuvendit, mund të diskutojnë por nuk mund të votojnë.
3. Aplikohet rregullorja mbi mirënjohjet dhe shpërblimet.

IV ORGANIZIMI

Neni 23 Organet dhe trupat konsultative

1. Organet e FFK-së janë :
 - a) **Kuvendi (organi legjislativ) ;**
 - b) **Komiteti Ekzekutiv (organ ekzekutiv) ;**
 - c) **Këshilli për qështje urgjente (organ për qështje të ngutshme) ;**
 - d) **Kryetari (organ përfaqësues) ;**
 - e) **Trupat juridike (organ gjykues);**
 - f) **Sekretari gjeneral (organ administrativ)**

2. FFK-ja ka këto trupa konsultative :
 - a) **Komisionet e përhershme ;**
 - b) **Komisionet Ad Hoc (të përkohshme, të rastit);**
 - c) **Shërbimi administrativ (profesional).**

3. FFK-ja cakton revizorin e posaçëm .

4. KE-ja mund të autorizoj komisionet e përhershme për të marrë vendime, siç është përcaktuar me rregulloret e tyre.

5. Të gjithë anëtarët e këtyre trupave dhe organeve do t'i përmbahen kodeksit të FIFA-së e UEFA-s në kryerjen e funksioneve të tyre, konform këtij Statuti dhe rregulloreve në fuqi.

6. Anëtari i KE-së nuk mund të jetë as delegatë i Kuvendit, as anëtar i trupave gjykuese apo Sekretar i përgjithshëm dhe e kundërta.

7. Anëtari i organit apo trupit statutar të FFK-së nuk mund të marrë pjesë në sjelljen e vendimeve rreth asnjë çështjeje, ku mund të ketë konflikt interesash.

8. Çdo anëtarë i këtyre trupave apo organeve ka një votë.

9. Votimi përmes autorizimit në organet apo trupat e FFK-së nuk lejohet.

Neni 24 Kushtet për tu bërë anëtar i organeve apo trupave të FFK-së

1. Që një person të kandidohet për organ apo trup statutar të FFK-së, duhet ti plotësoj këto kushte kumulative:
 - a) që të jetë i asocuar me njërën nga anëtarët e FFK-së;
 - b) të jetë i zgjedhur apo anëtarë i emëruar i FFK-së;
 - c) të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - d) të jetë mbi 18 vjeç dhe jo mbi 70 vjeç dhe i aftë për punë ;
 - e) të jetë aktiv në organizatën e futbollit ;
 - f) të mos jetë i larguar apo i suspenduar më herët nga FFK-ja apo anëtarët e saj;
 - g) të mos jetë i dënuar me Aktgjykim të plotëfuqishem për vepra penale.
2. Nëse një individ nuk i plotëson kushtet e lartpërmendura derisa është në pozitë, ai menjëherë humbë statusin e anëtarit të trupit apo organit të FFK-së.
3. KE-ja mund ti caktojë kushtet për referencë, diplomën përkatëse dhe kushtet e tjera.
4. Para se të fillojë punën në funksion të anëtarit apo trupit statutar ai duhet të obligohet në formë deklarate të shkruar për, si vijon:
 - a) se do ti përmbahet dhe respekton aktet normative të FFK-së, UEFA-së dhe FIFA-së;
 - b) se do ti respektojë rregullat e lojës të IFAB dhe të futbollit të vogël si dhe kodit etik të KE të FIFA-së;
 - c) se do të punojë në interesin e FFK-së dhe nuk do të vendosë aty ku lajmërohet apo mund të lajmërohet konflikti i interesave ;
 - d) se do të respektojë parimet e lojalitetit, integritetit dhe sjelljes sportive në frymën e fair play-it ;
 - e) se do të evitohet çfarëdo diskriminimi në baza politike, etnike, gjinore, religjioze, racore, gjuhësore dhe në baza të tjera;
 - f) se plotësisht do t'i respektojë kushtet për referencë të organit apo trupit që i takon;

- g) se do të njohë kompetencen ekskluzive të Gjykatës së arbitrazhit sportiv (CAS në Lozanë të Zvicrës) për kontestet nacionale dhe ndërkombëtare, pa iu drejtuar gjykatave civile.

A. Kuvendi

Neni 25 Organi më i lartë i FFK-së

1. Kuvendi është organi më i lartë i FFK-së i cili merr vendime.
2. Kuvendi mund të thirret si i rregullt, zgjedhor apo si i jashtëzakonshëm .
3. Puna e Kuvendit në të tri rastet, më tutje definohet me Rregulloren e Kuvendit, të cilën e aprovon Kuvendi.
4. Kuvendi i rregullt thirret së paku një herë në vit dhe zakonisht në fund të sezonit sportiv.
5. Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të thirret me kërkesën e Komitetit Ekzekutiv ose të së paku 50 % +1 të numrit të përgjithshëm të delegatëve të Kuvendit.
6. Me mbledhjet e Kuvendit udhëheq kryetari, në rast se ai mungon atëherë nënkryetari i parë, e nëse edhe ai mungon nënkryetari i dytë.
7. Për mbajtjen e çdo lloj Kuvendi duhet të lajmërohet FIFA dhe UEFA.

Neni 26 Përbërja

1. Në Kuvend thirren këta persona :
 - a) Kryetari dhe anëtarët e nderit;
 - b) Komiteti Ekzekutiv i FFK-së;
 - c) Kryesuesit e organeve dhe trupave statutare;
 - d) Mysafirët e tjerë që i thërret Komiteti Ekzekutiv;
2. Anëtarët e Kuvendit të FFK-së, me të drejtë vote përfaqësohen në këtë mënyrë:
 - a) dy delegatë, të zgjedhur nga çdo anëtar i Superligës së Kosovës;
 - b) një delegat, i zgjedhur nga çdo anëtarë i Ligës së parë;

- c) dy delegatë të propozuar nga Lidhjet Rajonale të Futbollit, me kusht që njëri nga ata të jetë përfaqësues i Ligës së dytë;
 - d) Kryetari i FFK-së;
 - e) Përfaqësuesi i zgjedhur nga Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës (SHGJK);
 - f) Përfaqësuesi i zgjedhur nga Shoqata e Trajnerëve të Kosovës (SHTK);
 - g) Përfaqësuesi i zgjedhur nga Shoqata e Futbollit të vogël (Futsall) (SHFV);
 - h) Përfaqësuesi i zgjedhur nga futbolli i femrave.
3. Delegatët zgjidhen në periudhë katër (4) vjeçare .
 4. Çdo ndërrim të delegatit duhet ta bëjë organi i cili e ka zgjedhë, por vetëm për pjesën e mbetur të mandatit dhe brenda kohës së lejuar.
 5. Anëtarët, duhet të njoftojnë shërbimin administrativ të FFK-së, për informatat më të reja rreth delegatëve të tyre , të dhënat, adresën dhe numrat e telefonave.
 6. Delegatët duhet të konfirmohen nga organi që e zgjedh dhe LRF-ja gjegjëse, në afatin e paraparë.
 7. Çdo delegatë duhet të vërtetojë pjesëmarrjen e tij në Kuvend më së largu 7 ditë para mbajtjes së Kuvendit, në shërbimin administrativ dhe në formë të shkruar.

Neni 27 Kompetencat

1. Kuvendi i FFK-së ka këto kompetenca:
 - a) Përcakton komisionin verifikues , procesmbajtësin, kryesinë e punës;
 - b) miraton apo ndryshon rendin e ditës;
 - c) miraton, Statutin e FFK-së, përshtatjen ose ndryshimin e tij ;
 - d) miraton rregulloren e punës së Kuvendit dhe ndryshimet e saj;
 - e) miraton procesverbalin e Kuvendit të fundit;
 - f) miraton raportin e punës së Kryetarit dhe KE-së;
 - g) miraton llogarinë vjetore të FFK-së;
 - h) miraton buxhetin vjetor të FFK-së;
 - i) zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe anëtarët e KE-së, me propozim të anëtarëve të FFK-së;

- j) ndanë titujt e kryetarit dhe anëtarëve të nderit;
- k) shqyrton, miraton apo i hudhë poshtë kërkesat e anëtarëve të FFK-së;
- l) vendosë mbi pranimin, suspendimin apo largimin e anëtarëve të FFK-së;
- m) vendosë për pushimin e punës së Federatës;
- n) miraton dorëheqjen e një anëtari;
- o) deklaron shkrirjen e FFK-së dhe likuidimin e veprimeve të saja financiare;

Neni 28 Kushtet për thirrje, propozimi i anëtarëve dhe kandidatëve

1. Kuvendin e rregullt e konvokon Sekretari gjeneral në bazë të vendimit të Komitetit Ekzekutiv.
2. Sekretari gjeneral duhet t'i njohtojë delegatët për mbajtjen e mbledhjes, 30 ditë përpara.
3. Sekretari gjeneral i dërgon thirrjet delegatëve, duke precizuar vendin, datën, kohën dhe rendin e ditës të propozuar, së paku 10 ditë para datës së mbledhjes.
4. Delegatët mund ti deponojnë në formë të shkruar propozimet për rend të ditës së paku 20 ditë para datës së mbledhjes.
5. Për Kuvendin zgjedhor delegatët mund të propozojnë kandidatët e tyre për zgjedhje në organet statutare të FFK-së, së paku 20 ditë para Kuvendit.

Neni 29 Kuorumi për marrjen e vendimeve dhe e drejta e votës

1. Kuvendi mbahet, nëse në të marrin pjesë së paku 50%+1, e numrit të përgjithshëm të delegatëve .
2. Nëse nuk ka kuorum, atëherë të nesërmen do të mbahet mbledhja e Kuvendit me të gjitha elementet e njëjta. Kuorumi për mbajtjen e mbledhjes mbetet i njëjtë.
3. E drejta për votë në Kuvend realizohet me ngritjen e dorës, përpos nëse Kuvendi nuk vendosë ndryshe.

4. Kuvendi, domosdo duhet të ketë kuorum, më së paku $2/3$ nga numri i përgjithshëm i delegatëve si dhe mbështetjen me votë të së paku $2/3$ e delegatëve prezent, për marrjen e këtyre vendimeve (nga rendi i ditës) :
 - a) miratimi i Statutit të FFK-së dhe rregullorës së punës së Kuvendit;
 - b) pranimi, suspendimi apo largimi i anëtarëve të FFK-së ;
 - c) emërimi dhe shkarkimi i kryetarit të FFK-së;
 - d) shkrirja e FFK-së dhe likuidimi i veprimeve të saja financiare;
5. Amandamenti Statutit mund të bëhet vetëm nëse janë prezent së paku $50\% + 1$ e delegatëve nga numri i përgjithshëm por amandamenti do të aprovohet nëse për të votojnë së paku $2/3$ e anëtarëve prezent.
6. Propozimi për amandamentim të Statutit duhet të bëhet nga anëtarët e FFK-së e mbështetur nga së paku 20 delegatë të Kuvendit të FFK-së dhe duhet të parashtrohet në afatin e paraparë kohor (20 ditë para mbajtjes së Kuvendit).
7. Kuorumi për marrjen e vendimeve për të gjitha çështjet tjera arrihet nëse për to voton shumica absolute ($50\%+1$) e delegatëve prezent në Kuvend.
8. Vota e atyre që "përmbahen" nuk llogaritet .
9. Vendimet e marra në Kuvend hyjnë në fuqi në ditën e ardhshme të punës.

Neni 30 Zgjedhjet

1. Zgjedhjet për kryetarë dhe anëtarë të KE-së, sipas rregullit janë të fshehta.
2. Zgjedhjet për anëtarë të Komitetit Ekzekutiv duhet të jenë të lira dhe bëhen në këtë mënyrë:
 - a) Kuvendi, së pari zgjedh Kryetarin e FFK-së,
 - b) Kuvendi pastaj zgjedhë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv.
3. Zgjedhjet e tjera për organet statutare të FFK-së, kryhen në listën e përbashkët për secilin trup, veç e veç.
4. Secili kandidat për Kryetar të FFK-së duhet të jetë i mbështetur me nënshkrimet e së paku 15 delegatëve ligjor të FFK-së.

5. Që të jenë të zgjedhur në rrethin e parë të votimit, kandidatët duhet të kenë së paku shumicën absolute (50% + 1) të votave të vlefshme, përpos kryetarit (shih n. 28 al.4 c).
6. Nëse nuk e arrijnë këtë kuorum, bëhet votimi i dytë, në të cilin kandidati të cilin e mbështetin shumica e thjeshtë e votave, fiton mandatin. Në rast të rezultatit të barabartë në rrethin e dytë, bëhet votimi i tretë, në të cilin zgjedhet kandidati i cili ka më shumë vota.
7. Në rast të rezultatit të barabartë në rrethin e tretë, zgjedhjen do ta vendosë Sekretari i përgjithshëm, me short.

Neni 31 Kuvendi i jashtëzakonshëm

1. Komiteti Ekzekutiv mund të thërret Kuvendin e jashtëzakonshëm në çdo kohë.
2. KE-ja duhet të thërret Kuvendin e jashtëzakonshëm, nëse këtë e kërkojnë së paku 50% +1, e numrit të përgjithshëm të delegatëve, në formë të shkruar dhe me nënshkrimet valide të tyre.
3. Kjo kërkesë duhet të këtë bazë të arësyeshme me të cilën përcaktohen pikat e rendit të ditës, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.
4. KE-ja është i obliguar të thërret Kuvendin e jashtëzakonshëm brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së kërkesës. Nëse kjo nuk bëhet, Sekretari gjeneral duhet menjëherë të thërras Kuvendin e jashtëzakonshëm në emër të delegatëve.
5. Sekretari gjeneral thërret delegatët e FFK-së së paku 20 ditë para mbajtjes së Kuvendit të jashtëzakonshëm në të cilin do t'i njoftojë për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së Kuvendit të jashtëzakonshëm.
6. Kur Kuvendin e jashtëzakonshëm e thirrë KE-ja, ajo përcakton rendin e ditës. Kur këtë e kërkojnë delegatët e FFK-së, rendi i ditës duhet t'i ketë ato pika të cilat ata i kërkojnë. KE-ja mund të plotëson rendin e ditës.
7. Rendi i ditës dhe të gjitha të dhënat dhe dokumentet, duhet t'u dërgohen delegatëve të FFK-së, së paku 10 ditë para mbajtjes së Kuvendit të jashtëzakonshëm.

8. Rendi i ditës së Kuvendit të jashtëzakonshëm nuk mund të ndërrohet gjatë mbajtjes së mbledhjes.
9. Vendimet e Kuvendit të jashtëzakonshëm hyjnë në fuqi ditën e parë të ardhshme të punës.

Neni 32 Proçesverbali

1. Proçesverbalin e mbledhjes së Kuvendit e mban personi të cilin e cakton Kuvendi.
2. Delegatët e caktuar për verifikimin e proçesverbalit do ta marrin atë në formë zyrtare, për shqyrtim dhe verifikim më së voni 15 ditë pas mbledhjes.
3. Këta delegatë mund t'i përcjellin komentet e tyre Sekretarit gjeneral në afat prej 30 ditësh.
4. Proçesverbali i tillë i prezentohet Kuvendit të radhës në miratim.
5. Sekretari gjeneral është përgjegjës për minutazhën në Kuvend.

B. KOMITETI EKZEKUTIV

Neni 33 Përbërja, zgjedhjet dhe mandati

1. Komiteti Ekzekutiv është organ ekzekutiv i FFK-së
2. Komiteti Ekzekutiv ka 13 anëtarë dhe përbëhet prej:
 - a) kryetarit,
 - b) tre nënkryetarëve, (njëri nga ta të jetë nga minoritetet)
 - c) nëntë anëtarëve të saj
3. Anëtarët e KE-së kanë mandat katër vjeçar dhe mund të zgjedhen më së shumti për tri mandate (pa efekt retroaktiv). Kryetari zgjedh vetë tre anëtarë për KE, ndërsa shtatë (7) të tjerë i zgjedhin LRF-të. Anëtarë të KE-së, zgjedhen edhe nga një përfaqësues i minoriteteve që jetojnë në Kosovë dhe i futbollit të femrave
4. Nëse zbrazet një vend në KE, Kuvendi e zgjedh zëvendësuesin, për pjesën e mbetur të mandatit.
5. KE-ja zgjedh dy nënkryetarët me propozim të kryetarit, ndërsa njëri propozohet nga KE-ja gjegjësisht nga LRF-të, në mbledhjen e parë.

6. Nuk mund të kandidohet për anëtar të KE personi i cili i ka mbushur 70 vjet e më shumë si dhe duhet të mos jetë i dënuar me aktgjykim të plotëfuqishem për vepra penale.
7. Aplikohet rregullorja e Kuvendit dhe kushtet për referencë, për Komitetin Ekzekutiv.

Neni 34 Të drejtat dhe obligimet

1. Komiteti Ekzekutiv është i autorizuar të merrë vendime për të gjitha çështjet të cilat nuk hyjnë në kompetencën juridike dhe statutare të Kuvendit apo organit tjetër në FFK.
2. KE-ja është organi kryesor dhe përgjegjës për politikën dhe strategjinë e FFK-së.
3. Komiteti Ekzekutiv ka këto kompetenca :
 - a) lidhur me Kuvendin :
 - përgatitë dhe thërret Kuvendin;
 - mbikqyrë zbatimin e vendimeve të Kuvendit;
 - propozon kryetarin dhe anëtarët e nderit;
 - propozon kompaninë e revizionit për revizor të pavarur;
 - aprovon rregulloret e FFK-së, të cilat nuk janë në kompetencë të Kuvendit;
 - kryen detyra tjera për të cilat e autorizon Kuvendi apo ky Statut.
 - b) Për FFK-në si federatë nacionale:
 - kryen kontrollën e përgjithshme të FFK-së dhe jep instrukcionet e domosdoshme;
 - nxjerrë dhe mbikqyr planin e punës dhe strategjinë e FFK-së;
 - aprovon sistemin e garave dhe kalendarin e garave për Kosovë, që duhet të jetë në harmoni me kalendarin e FIFA-së dhe UEFA-së;
 - aprovon programet e zhvillimit dhe edukimit të të gjitha kategorive të futbollit në Kosovë;
 - emëron dhe shkarkon seleksionuesit e Përfaqësueseve;
 - bënë politikën komerciale dhe miraton të gjitha kontratat komerciale të FFK-së (të drejtat televizive sponsorimin, etj);
 - vendosë për mirënjohjet dhe shpërblimet ;

c) Për FFK-në dhe trupat dhe organet e saj

- emëron dhe shkarkon kryetarët, nënkryetarët dhe anëtarët e të gjitha komisioneve të përhershme dhe ad hoc (të përkohshme);
- shqyrton raportet vjetore të komisioneve dhe trupave juridike;
- aprovon kushtet për referencë për të gjitha organet dhe trupat statutare si dhe ndryshimet tyre;

-

d) Për Shërbimin administrativ dhe Sekretarin e përgjithshëm

- emëron (me propozim të kryetarit) dhe shkarkon Sekretarin e përgjithshëm;
- miraton organizimin e shërbimit administrativ dhe rregulloret gjegjëse me propozim të Sekretarit të përgjithshëm;
- përcakton formën dhe përmbajtjen e simboleve zyrtare të FFK-së;
- përcakton çmimet dhe taksat për shërbimet që kryen FFK-ja dhe shërbimi i saj administrativ;

e) Për të gjitha format e bashkëpunimit dhe qështjet ndërkombëtare

- Vendosë për bashkëpunimin me organizatat e tjera sportive, të cilat u përmbahen qëllimeve dhe obligimeve të përbashkëta dhe përcakton përfaqësuesit e saj për këtë qështje;
 - Vendos dhe formulon direktivat për bashkëpunim me FIFA, UEFA, konfederatat tjera dhe me LRF-të;
 - Vendosë për bashkëpunimin në futbollin ndërkombëtar ;
 - Aplikon vendimet që dalin nga Statuti, rregulloret dhe vendimet e FIFA-së e UEFA-së;
4. Komiteti Ekzekutiv vendosë mbi të gjitha qështjet tjera të cilat nuk hyjnë në kompetencën e Kuvendit apo të ndonjë organi tjetër statutar.

Neni 35 Mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv

1. Mbledhjet e KE-së, thirren së paku një herë në dy muaj.

2. Mbledhjet i thërret Kryetari, së paku 7 ditë përpara, nëse ai mungon këtë e bënë nënkryetari i parë.
3. Nëse së paku pesë anëtarë të KE-së kërkojnë mbledhje atëherë Kryetari duhet t'a thërret atë brenda afatit prej 7 ditësh.
4. Rendin e ditës përfundimisht e miraton Kryetari dhe ai këtë ua përcjellë anëtarëve të KE-së, së paku pesë ditë para mbledhjes.
5. Sekretari gjeneral merr pjesë në mbledhjen e KE-së në rol këshilltari.
6. Mbledhjet i udhëheq Kryetari i KE-së, ndërsa në mungesë nënkryetari i parë, e në mungesë të tij nënkryetari i dytë.
7. Mbledhjet e KE-së nuk janë publike. Megjithatë KE-ja mund të thërret palën e tretë të marrë pjesë në mbledhje por ato nuk kanë të drejtë vote dhe mund të shprehin mendimin e tyre vetëm kur këtë e kërkon KE-ja.

Neni 36 Kuorumi, për mbledhje dhe marrjen e vendimeve

1. Komiteti Ekzekutiv i FFK-së merr vendime meritore nëse në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve dhe nëse për to vendosë më shumë se gjysma e anëtarëve prezent. Nëse nuk ka kuorum për mbajtje të mbledhjes, ajo automatikisht mbahet të nesërmen por me elemente të njëjta.
2. Në rastë të rezultatit të barabartë në votime, vota e Kryetarit është përcaktuese. Votimi me autorizim dhe në mungesë nuk lejohet.
3. Vendimet bëhen me ngritjen e dorës pos nëse anëtarët e KE-së nuk vendosin ndryshe.
4. Komiteti Ekzekutiv për punën e vet i përgjigjet Kuvendit.

C. Këshilli për çështje urgjente

Neni 37 Këshilli për çështje urgjente

1. Këshillin për çështje urgjente e përbëjnë Kryetari dhe katër anëtarët e zgjedhur nga KE.

2. Këshilli për çështje urgjente vendos për çështjet që janë në kompetencë të KE-së, në mes dy mbledhjeve të rregullta, e të cilat kërkojnë zgjidhje të shpejtë.
3. Ky këshill mund të vendosë nëse në të marrin pjesë së paku 4 anëtarët e lartëpërmendur. Në mbledhje mund të vendoset edhe me letër të shkruar apo telefon. Vendimi është valid nëse për të votojnë së paku tre nga pesë anëtarët .
4. Vendimi i tillë ka efekt të menjëhershëm ligjor. Kryetari duhet të njohtojë menjëherë anëtarët e tjerë të KE-së për këto vendime.
5. Këto vendime duhet të verifikohen në mbledhjen e radhës së Komitetit Ekzekutiv.
6. Sekretari gjeneral merr pjesë në marrjen e vendimeve por nuk ka të drejtë vote.
7. Aplikohet rregullorja për punën e Komitetit Ekzekutiv.

D. Kryetari

Neni 38 Kryetari

1. Kryetari përfaqëson zyrtarisht Federatën e Futbollit të Kosovës (FFK).
2. Obligimet dhe përgjegjësitë e Kryetarit janë:
 - a) implementon vendimet e Kuvendit nëpërmjet Komitetit Ekzekutiv (KE) dhe Sekretariatit të përgjithshëm,
 - b) përkujdeset dhe siguron funksionimin e të gjitha trupave të FFK-së, për të arritur objektivat e përshkruara në këtë Statut,
 - c) Përgjigjet për marrëdhëniet mes FFK-së dhe anëtarëve të saj, mes FFK-së, FIFA-s dhe UEFA-së, si dhe me trupat politike dhe organizatat tjera.
 - d) Mbikqyrë programet e hartuara nga Komiteti Ekzekutiv (KE), dhe punën e Sekretariatit të përgjithshëm.
3. Kryetari duhet të kryesojë me Kuvendin, Komitetin Ekzekutiv dhe Këshillin për çështje urgjente si dhe me ato komisione apo këshilla ku është përcaktuar t'i kryesojë.
4. Kryetari i FFK-së ka votë të rregullt në Kuvend dhe Komitetin Ekzekutiv dhe kur votat janë të barabarta atëherë vota e Kryetarit është vendimtare.

5. Nëse Kryetari mungon ose nuk është në dispozicion, atëherë atë e zëvendëson nënkryetari i parë.

Neni 39 Kushtet për zgjedhjen e Kryetarit

1. Kryetari zgjedhet në Kuvendin e FFK-së, për periudhë katërvjeçare dhe mandati i tij fillon menjëherë pas përfundimit të Kuvendit i cili e ka zgjedhur. Kryetari mund të zgjedhet më së shumti tri mandate (klauzola nuk ka efekt retroaktiv).
2. Kryetar i FFK-së zgjedhet ai kandidat i cili në rrethin e parë fiton 2/3 e votave valide të Kuvendarëve prezent në rrethin e parë të zgjedhjeve. Nëse asnjëri kandidat nuk e ka numrin e mjaftueshëm të votave atëherë vetëm dy kandidatët me më së shumti vota hyjnë në raundin e dytë, ndërsa kandidatët tjerë eliminohen. Në këtë rast kandidati i cili fiton më shumë vota valide, zgjedhet Kryetar i FFK-së.
3. Vetëm anëtarët e FFK-së mund të propozojnë kandidatin për Kryetar të FFK-së. Propozuesi duhet të protokolojë propozimin në Sekretariatit Gjeneral të FFK-së, në formë të shkruar dhe duke i deponuar së paku 15, nënshkrime të delegatëve legjitim të Kuvendit të FFK-së, me të dhënat e nevojshme, së paku dy muaj para datës së mbajtjes së Kuvendit të rregullt zgjedhor. Poashtu duhet të parashtrahet programi i punës. sekretariati i përgjithshëm duhet që t'i notifikojë kandidatët për kryetar të FFK-së, së paku një muaj para mbajtjes së Kuvendit.
4. Nuk mund të kandidohen për kryetarë dhe anëtarë të KE-së, personat që janë apo kanë qenë në pozita ekzekutive, politike dhe ligjvënëse në Institucionet e Republikës së Kosovës, së paku dy vitet e fundit.

Neni 40 Përfaqësimi dhe nënshkrimi

KE përfaqëson FFK-në zyrtarisht përballë palëve të treta, nëpërmjet firmave (nënshkrimeve) të Kryetarit dhe Sekretarit të përgjithshëm.

E. Trupat juridike

Neni 41 Trupat juridike

1. Trupat juridike të FFK-së përbëhen nga trupat gjykuese dhe trupat për licencimin e klubeve .
2. Trupat gjykuese të FFK-së janë :
 - a) komisioni disiplinor ;
 - b) komisioni për ankesa ;
3. Trupat për licencim të klubeve të FFK-së janë :
 - a) komisioni për licencimin e klubeve dhe
 - b) komisioni për ankesa lidhur me licencimin e klubeve.

Neni 42 Zgjedhjet, detyrat dhe pamvarësia e trupave juridike

1. Anëtarët e trupave juridike (nuk mund të kandidojnë nëse janë mbi 70 vjeç) i zgjedh Komiteti Ekzekutiv i FFK-së me mandat katër vjeçar. Ata mund të rizgjedhen.
2. Anëtari i këtyre organeve nuk mund të jetë në ndonjë organ apo trup tjetër të FFK-së.
3. Anëtari duhet të merrë pjesë në mbledhje dhe të vendos përmes votës.
4. Fushëveprimin, kompetencat dhe procedurën e marrjes së vendimeve të trupave gjykuese i përcakton rregullorja disiplinore dhe rregulloret tjera.
5. Të drejtat, detyrimet dhe profili i kërkuar profesional për anëtarë të këtyre organeve, përcaktohet me kushtet për referencë të cilat i aprovon Komiteti Ekzekutiv.

Neni 43 Masat disiplinore dhe direktivat

1. Në rast të sjelljes jo sportive, shkeljes së Statutit, rregulloreve dhe vendimeve të FFK-së, trupat juridike të FFK-së kanë autorizim të aplikojnë masat disiplinore dhe vendimet në harmoni me këtë Statut dhe rregulloret disiplinore.

2. Lejohet aplikimi i më shumë masave disiplinore, po ashtu i më shumë vendimeve, rreth një qështjeje (lënde) të caktuar.
3. Mund të merret vendim dhe shtesë tjetër masës disiplinore. Ajo definon si do të ekzekutohet masa disiplinore ose si të funksionojë pala e lidhur me lëndën.
4. Jashtë sanksioneve sportive të shqiptuara nga organet e FFK-së, anëtarët e FFK-së i nënshtrohen ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, Kodit Penal dhe Ligjit mbi parandalimin e dhunës në Sport.

Neni 44 Masat disiplinore kundër anëtarëve dhe klubeve

1. Kundër anëtarëve, klubeve apo personave tjerë juridik mund të aplikohen masat disiplinore si vijon.

2. Në lidhje me anëtarët :

- a) Paralajmërim (vërejtje);
- b) vërejtje e rëndë;
- c) gjobë (dënimi në të holla) ;
- d) anulimi rezultatit të ndeshjes ;
- e) urdhëri për zhvillimin e sërishëm të ndeshjes ;
- f) zbritja e pikëve ;
- g) regjistrimi i ndeshjes në favor të një klubi ;
- h) zhvillimi i ndeshjes pa spektator;
- i) zhvillimi i ndeshjes në territor neutral;
- j) dënimi i stadiumit;
- k) ndalimi i prodhimit të sinjalit televiziv për një ose më shumë ndeshje dhe /ose që sinjali televiziv për një ose më shumë ndeshje të jetë pa pagesë.
- l) diskualifikim nga ndeshjet në vijim dhe/ose përjashtim nga kampionati i ardhshëm.
- m) largim ;
- n) dërgimi në rang më të ulët ;
- o) ndalimi i transferit;

3. Në lidhje me personat privat (individë)

- a) Paralajmërim (vërejtje);
- b) vërejtje e rëndë;
- c) gjobë;
- d) largim;
- e) suspendim për një numër të caktuar ndeshjesh ose periudhë të caktuar;
- f) ndalim prezence në zhveshtore apo bankën e "rezervistëve";
- g) ndalesa e marrjes pjesë në çdo aktivitet të lidhur me futbollin;

Neni 45 Komisioni disiplinor

- 1. Komisioni disiplinor përbëhet nga tre anëtarë.
- 2. Vendimet mund të merren vetëm kur janë prezentë së paku kryetari dhe një anëtarë. Kryetari duhet të jetë jurist.
- 3. Aplikohet rregullorja disiplinore.

Neni 46 Komisioni për ankesa

- 1. Komisioni për ankesa përbëhet nga tre anëtarë.
- 2. Dy nga anëtarët medoemos duhet të jenë jurist.
- 3. Vendimet merren vetëm kur komisioni është në përbërje të plotë, dhe vendosë për ankesat kundër vendimeve të komisionit disiplinor.
- 4. Aplikohet rregullorja disiplinore.

Neni 47 Komisioni për licencimin e klubeve për garat ekipore të UEFA-së

- 1. Komisioni për licencimin e klubeve përbëhet nga pesë anëtarë.
- 2. Ata marrin vendime për dhënjën apo për mos dhënjën e licencës klubit aplikant, kur janë në përbërje të plotë.

3. Nga pesë anëtarët, njëri duhet të jetë jurist, ekonomist, tjetri ekspert financiar, si dhe ish punëtor i dalluar sportiv me diplomat përkatëse.
4. Aplikohet rregullorja mbi licencimin e klubeve të cilën e aprovon KE-ja dhe UEFA.

Neni 48 Komisioni për ankesa në licencim për garat ekipore të UEFA-së

1. Ky komision përbëhet nga pesë anëtarë.
2. Ajo vendosë vetëm në përbërje të plotë dhe me referencat e njëjta profesionale
3. Ajo merret me ankesat kundër vendimeve të komisionit për licencimin e klubeve.
4. Aplikohet rregullorja e lartpërmendur për licencimin e klubeve.
5. Ndaj vendimeve të këtij komisioni pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në CAS.

F. Komisionet e përhershme dhe të përkohshme

Neni 49 Komisionet e përhershme

1. Komisionet e përhershme kanë rol konsultativ në FFK dhe ato, për punën e tyre i raportojnë KE-së.
2. KE-ja mund të autorizojë komisionin përkatës, varësisht nga funksioni i saj, që të merrë vendime, të cilat duhet të jenë në harmoni me aktet normative të FFK-së, UEFA-së dhe FIFA-s.
3. Komisionet e përhershme të FFK-së janë:
 - a) Komisioni për zhvillim dhe licencim të klubeve;
 - b) Komisioni i garave (komesari);
 - c) Komisioni për statusin dhe regjistrimin e lojtarëve;
 - d) Komisioni për futbollin e femrave;
 - e) Komisioni për futbollin e të rinjve;
 - f) Komisioni për Futsall;
 - g) Komisioni për marketing;
 - h) Komisioni për stadione dhe infrastrukturë;

- i) Komisioni për delegimin e gjyqtarëve;
 - j) Komisioni për gjyqtarë;
 - k) Komisioni për qështje të trajnerëve;
 - l) Komisioni për qështje mjekësore;
 - m) Komisioni për ndarjen e shpërblimeve;
 - n) Komisioni për financa;
4. Anëtarët e komisionit i emëron KE-ja për periudhën dy vjeçare.
 5. KE-ja definon përbërjen, qëllimet, të drejtat dhe detyrimet, autorizimet për marrjen e vendimeve si dhe procedurën e brendshme të çdo komisioni nëpërmes kushteve për referenca.
 6. Komisioni për gjyqtarë përbëhet nga ish gjyqtarët dhe i ka këto detyra:
 - a) aplikon dhe implementon rregullat e lojës të IFAB si dhe rregullat e lojës për futboll të vogël të cilat i përcakton KE e FIFA-së;
 - b) Përcakton gjyqtarët për garat e organizuara nga FFK-ja;
 - c) Është përgjegjës për rekrutimin, edukimin dhe shkollimin e gjyqtarëve të Superligës dhe ligës së parë të FFK-së;
 - d) Bashkëpunon me shoqatën e gjyqtarëve të FFK-së;
 7. Komiteti Ekzekutiv definon përbërjen, qëllimin, të drejtat, obligimet dhe autorizimin për marrjen e vendimeve si dhe procedurën e brendshme të këtij komisioni.

Neni 50 Komisionet Ad Hoc (të përkohshme)

1. Komiteti Ekzekutiv mund të formojë komisione për detyra të veçanta dhe për kohë të caktuar.
2. KE-ja emëron kryetarin dhe anëtarët në kushtet e referencës dhe definon qëllimet, të drejtat, obligimet dhe afatet.
3. Poashtu, përcakton buxhetin dhe përkrahjen e nevojshme administrative për kryerjen e detyrave të tyre.

G. Sekretariati gjeneral (i përgjithshëm)

Neni 51 Sekretariati gjeneral (i përgjithshëm)

1. Sekretariati Gjeneral përkujdeset për të gjitha punët administrative të FFK-së, nën udhëheqjen e Sekretarit Gjeneral të FFK-së.
2. Punëtorët e administratës së Sekretariatit, duhet të lidhin kontratë, gjegjësisht marrëdhënie pune sipas Ligjit mbi punën dhe duhet t'i plotësojnë kriteret e kërkuara në formën më të mirë.

Neni 52 Sekretari gjeneral (i përgjithshëm)

1. Sekretari gjeneral është shef ekzekutiv i Sekretariatit të përgjithshëm në FFK dhe është organi më i lartë operativ në FFK.
2. Atë e vendos Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, me propozim të kryetarit, në periudhë katërvjeçare dhe mund të zgjedhet përsëri. Ai lidhë marrëdhënie pune me FFK-në, në bazë të Ligjit mbi punën të Kosovës.
3. Gjatë ushtrimit të funksionit të tij, Sekretari Gjeneral nuk mund të jetë në asnjë trup apo organ statutar të FFK-së.
4. Ai është përgjegjës për :
 - a) Implementimin e vendimeve të Kuvendit dhe Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, në bashkëveprim dhe drejtim të kryetarit;
 - b) Përgatitjen e mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komitetit Ekzekutiv si dhe mbikqyr punën e të gjitha komisioneve të përhershme apo të përkohshme;
 - c) Udhëheq me administratën e FFK-së, bënë punësimin dhe shkarkimin e tyre si dhe jep instruksione për shërbimin profesional;

- d) Menagjon dhe mbikqyrë shërbimin e kontabilitetit dhe financiar si dhe përgatit planin e buxhetit vjetor të FFK-së;
- e) Kujdeset për marrëdhëniet me anëtarët e FFK-së, si dhe me zyrtarët e FIFA-së dhe UEFA-së dhe organizmave tjerë ndërkombëtarë si dhe informon publikun për aktivitetet e FFK-së,
- f) Merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit të KE-së dhe trupave tjerë të FFK-së, në rol këshillues dhe mbikqyrë punën e të gjitha komisioneve dhe shoqatave,
- g) Kryen edhe detyra tjera që i përcakton KE i FFK-së.

H. Shërbimi administrativ

Neni 53 Detyrat

1. Nën mbikqyrjen e Sekretarit gjeneral shërbimi administrativ i kryen obligimet ditore në FFK.
2. Shërbimi administrativ përbëhet nga personeli i punësuar dhe përkohësisht të angazhuar të cilët ndihmojnë Sekretarin gjeneral në kryerjen e detyrave për arritjen e qëllimeve të FFK-së.
3. Ajo vazhdimisht përkrah dhe këshillon anëtarët e FFK-së.
4. Të punësuarit dhe përkohësisht të angazhuarit kryejnë detyrat dhe obligimet administrative, financiare, komerciale, juridike, teknike, informatike etj konform rregullores mbi organizimin e shërbimit administrativ.
5. Sekretari i përgjithshëm është përgjegjës për punën e shërbimit administrativ.
6. Me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm (S.P.), KE cakton Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm i cili mund të zëvendësojë S.P. në detyrat e caktuara përpos të të drejtat Statutare të S.P.

V. FINANCIMI

Neni 54 Afarizmi financiar dhe viti financiar

1. Sekretari i përgjithshëm dhe shërbimi financiar janë përgjegjës për afarizmin financiar të FFK-së, në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës.
2. Viti financiar përfshin vitin kalendarik.
3. Shërbimi administrativ bënë buxhetin e të hyrave dhe të dalurave për çdo vit financiar dhe ia paraqet komisionit për financa në shikim.
4. Në fund të çdo sezoni, gjendja financiare (bilanci i gjendjes dhe i suksesit) duhet t'i dorëzohet komisionit për financa dhe revizorit të pavaruar në kontrollim.
5. Komisioni për financa dhe revizori i pavarur i raportojnë Komitetit Ekzekutiv për këtë lëndë.
6. Komiteti Ekzekutiv i dërgon për miratim Kuvendit raportet financiare, raportin e revizionit dhe buxhetin për sezonin në vijim.
7. FFK-ja ka xhirrollogarinë e vetë bankare.

Neni 55 Të hyrat dhe të dalurat

1. FFK-ja krijon të ardhura nga :
 - a) Anëtarësia;
 - b) të drejtat televizive ;
 - c) biletat;
 - d) reklamat ;
 - e) të ardhurat nga ndeshjet e përfaqësuesës së Kosovës;
 - f) donacionet dhe dhuratat ;
 - g) dënimet;
 - h) pagesat financiare të klubeve , lojtarëve etj;
 - i) të ardhurat nga marketingu;

- j) sponzorizimi;
- k) burimet tjera;

2. Këto të ardhura do të shfrytëzohen për mbulimin e këtyre sferave:

- a) zhvillimin e të gjitha aspekteve të futbollit në Kosovë;
- b) shpenzimet e reprezentacionit ;
- c) shërbimit administrativ;
- d) për programet e edukimit dhe shkollimit;
- e)shpenzimet e trupave dhe organeve të FFK-së dhe
- f) shpenzime të tjera.

Neni 56 Revizori i pavarur

1. Revizorin e pavarur e emëron Kuvendi. Ai kontrollon faturat të cilat i aprovon komisioni për financa, konform principeve të kontabilitetit të legjislaturës së Kosovës.
2. Raportet e revizorit duhet t'i prezentohen Komitetit Ekzekutiv dhe pastaj në formë të pandryshuar Kuvendit për miratim.
3. Revizori i pavarur duhet te jetë kompani e mirënjohur revizore e cila vendoset në periudhë prej dy vitesh. Ky mandat mund të ripërtrihet.

VI GARAT DHE E DREJTA E PJESËMARRJES NË GARA DHE NGJARJET SPORTIVE

Neni 57 Garat

1. FFK-ja organizon dhe udhëheqë këto gara zyrtare në teritorin e Kosovës:
 - a) Kampionatin e Kosovës, të Superligës, ligës së parë dhe ligën e dytë;
 - b) Play off-in dhe play aut-in eventual për plotësimin e ligave;
 - c) Garat për kupën shtetërore;

- d) Garat e futbollit të femrave dhe KUP-ën përkatëse;
 - e) Kampionatin nacional për Futsal;
 - f) Superligën, Ligën e parë për juniorë dhe për kadetë;
 - g) Garat përfundimtare të grupmoshave të reja;
2. KE-ja mund të delegojë organin e vet për organizimin e garave të përhershme në nivel rajonal për LRF dhe anëtarët e tjerë.
 3. Garat e deleguara nuk mund të prishin rendin e garave tjera të organizuara nga FFK-ja.
 4. Garat ndërkombëtare në të cilat marrin pjesë klubet e Kosovës dhe përfaqësuesës së saj janë nën kompetencat e UEFA-së dhe FIFA-së.
 5. Shërbimi administrativ i kryen detyrat e veta administrative rreth udhëheqjes me gara të FFK-së, me ndihmën e komisioneve dhe komesarëve të emëruar nga KE-ja e FFK-së.

Neni 58 Të drejtat mediale

1. FFK-ja është pronare e të gjitha të drejtave që dalin nga garat dhe ngjarjet tjera sportive në kompetencë të saj. Këto të drejta, përpos tjerash, përfshijnë të gjitha të drejtat financiare, audiovizuale dhe inçizimet e radios, të drejtat e reproduksionit dhe përcjelljes së transmetimit, të drejtat multimediale, të drejtat e marketingut dhe reklamës si dhe të drejtat e veçanta, siç janë të drejtat lidhur me amblemet dhe të drejtat që rrjedhin nga ligji mbi mbrojtjen e të drejtave të autorit.
2. KE-ja vendosë se si dhe në çfarë mase do ti shfrytëzojë këto të drejta dhe do t'i përpiloj rregulloret e posaçme për këte. KE-ja vetë do të vendosë se a do të shfrytëzohen ekskluzivisht këto të drejta apo së bashku me palën e tretë ose plotësisht me palën e tretë.

Neni 59 Pasuria e përbashkët

1. Komiteti Ekzekutiv do të nxjerrë rregulloren me të cilën i ndalohet çdo ndërrmarrjeje komerciale (duke përfshirë edhe kompanitë holding dhe filialet e kompanisë), personit privat apo trupit tjetër juridik të posedojë interesin e kontrollit ose të jetë pronarë i më shumë se një klubi brenda FFK-së.

VII DISPOZITAT TJERA

Neni 60 Licencimi i klubeve

1. Pjesëmarrja e klubeve në garat e organizuara nga FFK-ja ose në garat ekipore të UEFA-së i nënshtrohen marrjes së licencës, të cilat i lëshojnë trupat e FFK-së për licencim të klubeve.
2. Procesi i licencimit dhe vendosjes së kriterëve të cilat duhet t'i plotësojnë klubet janë të precizuara në Rregulloren për licencimin e klubeve të FFK-së dhe UEFA-s, të cilën e aprovon KE-ja për gara nacionale dhe KE i UEFA-së për garat ekipore të organizuara nga UEFA.

Neni 61 Legjislatura e FFK-së

1. Legjislaturën e FFK-së e përbëjnë Statuti, rregulloret, direktivat dhe vendimet të cilat i nxjerrin trupat përkatëse.
2. Ky Statut është akti themelor dhe konstituiv juridik i FFK-së.
3. Të gjitha aktet tjera juridike duhet të jenë në harmoni me këtë Statut.
4. Rregulloret janë akte të përgjithshme që rregullojnë veprimtaritë e posaçme që janë në kompetencë të FFK-së.
5. Vendimet janë aktet individuale juridike të bazuara në legjislaturën sportive të FFK-së, të cilat aplikohen për anëtarët apo individët e asocuar në FFK.
6. Rregullorja e Kuvendit definon aplikimin dhe implementimin e dispozitave statutare në detaje.
7. Kushtet për referencë janë rregulla të brendshme të cilat aplikohen për anëtarët e organeve dhe trupave të FFK-së, të cilat janë të precizuara në këtë Statut.

Neni 62 Ndryshimi i Statutit

1. Çdo anëtarë i FFK-së, ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e Statutit të FFK-së.
2. Këto propozime duhet t'i dorëzohen komisionit për çështje juridike në shqyrtim, duke dhënë vërejtjet dhe arsyetimin se këto amandamente janë konform legjislaturës së Kosovës.
3. Komisioni për çështje juridike i raporton Sekretarit të Përgjithshëm dhe KE-së.
4. KE-ja ua dërgon këtë raport anëtarëve të FFK-së për dhënjën e vërejtjeve dhe sugjerimeve.
5. Pas kësaj, me mbështetjen e Komisionit për çështje juridike KE-ja definon verzionin final të Statutit dhe ia përcjellë këtë FIFA-së dhe UEFA-së për mendimin final.
6. Nëse miratohet, KE-ja ua përcjellë ndryshimet e Statutit delegatëve të Kuvendit në miratim.

Neni 63 Transparenca në punë

1. Aktivitetet e FFK-së janë në princip të hapura për publik.
2. FFK-ja rregullisht informon publikun nëpërmes:
 - a) qasjes në dokumentacion dhe raporte, palëve dhe personave të interesuar;
 - b) komunikatat për media dhe konferencat për media;
 - c) përmes website-it zyrtar të FFK-së.
3. FFK-ja informon për aktet tjera juridike dhe vendimet e përgjithshme përmes buletinit zyrtar të cilat i dërgohen çdo klubi të FFK-së.
4. Mbledhjet dhe vendimet e KE-së, Këshillit për çështje urgjente, organeve juridike dhe komisioneve të përhershme dhe të përkohëshme, nuk janë publike. Mirëpo, vendimet në interes të përgjithshëm për futbollin dhe publikun mund t'i dorëzohen publikut nëse respektohen rregullat mbi informatat e besueshme.

Neni 64 Shuarja

1. FFK-ja mund të shuhet me kërkesën e anëtarëve të saj.
2. Këtë kërkesë duhet ta shqyrtojë Kuvendi i jashtëzakonshëm, në të cilën nuk do të ketë pika tjera në rendin e ditës.
3. Neni 28 pika 4 do të aplikohet për kuorumin e pjesëmarrjes dhe kuorumin për marrjen e vendimeve .
4. Ministria për Sport nëpërmjet Departamentit për Sport do të njohtohet për shuarjen e FFK-së, në afat prej 8 ditësh.
5. Pasuria e gjithëmbarshme e FFK-së do të bartet në këtë trup qeveritar derisa të mos themelohet federata e re, me të njëjtat qëllime dhe obligime.

VIII KONTESTET

Neni 65 Arbitrazhi

1. Komisioni i arbitrazhit i KOK (Komiteti Olimpik i Kosovës) merret me kontestet juridike, që ndodhin në mes FFK-së, anëtarëve të saj, zyrtarëve dhe të gjitha organeve tjera të lidhura me kontestet e aplikimit të Statutit dhe rregulloreve, e të cilat nuk janë në kompetencë të trupave juridike sportive të FFK-së, FIFA-s dhe UEFA-s.
2. Komisioni i arbitrazhit i KOK-ut përcaktohet dhe funksionon në bazë të Rregulloreve të KOK-ut.

Neni 66 Jurisdiksioni

1. FFK-ja, anëtarët e saj, zyrtarët, agjentët e lojtarëve dhe të ndeshjeve, nuk duhet t'u drejtohen gjykatave civile pa iu drejtuar organeve juridike të FFK-së, UEFA-së dhe FIFA-së.
2. FFK-ja ka jurisdiksion në çështjet interne nacionale dhe që i takojnë asaj. FIFA ka jurisdiksion në kontestet ndërkombëtare mes palëve që i takojnë federatave apo konfederatave të tjera.

Neni 67 Gjykata për arbitrazh sportiv (CAS)

1. Në bazë të nenit 59 dhe 60 të Statutit të FIFA-së, çdo ankesë kundër vendimit final të FIFA-së, duhet t'i drejtohet Gjykatës për Arbitrazh sportiv (CAS në Lozanë, Zvicër).
2. FFK-ja siguron se ajo dhe anëtarët e saj do të respektojnë vendimet e marra nga trupat e FIFA-së apo CAS.

IX DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 68 Rastet e paparashikuara dhe "fuqia madhore"

Të gjitha çështjet që nuk janë të definuara në këtë Statut ose rastet e fuqisë madhore, do t'i zgjedhë KE-ja e FFK-së në harmoni me drejtësinë dhe të drejtën. Nuk mund të paraqitet ankesa në kësi lloj vendimesh.

Neni 69

Ky Statut u aprovua në Kuvendin e mbajtur në Prishtinë më 25.08.2017 me ndryshimet e kuvendit të datës 02.03.2008, dhe hyn në fuqi ditën e parë të punës.

Neni 70 Dispozitat kalimtare

1. FFK-ja duhet të harmonizojë rregulloret e veta dhe atë disiplinore, konform këtij Statuti, më së voni deri në 30 Prill 2018. Të gjitha rregulloret tjera dhe kushtet për referencë duhet të adaptohen deri në fund të Qershorit 2018.

2. Anëtarët e FFK-së, duhet t'i adaptohen këtij Statuti dhe duhet t'i aplikojnë dispozitat e kërkuara në Statutet e tyre dhe rregulloret përkatëse. Poashtu, ata duhet të sigurojnë që edhe anëtarët e tyre të bëjnë të njejtën gjë.

Prishtinë, 02.03.2018

Për Federatën e Futbollit të Kosovës:

Kryetari i FFK-së

Fadil Vokrri

Sekretari i përgjithshëm

Eroll Salihu